

Komuna e Prishtinës
Municipality of Prishtina
www.prishtina-komuna.org




Komuna e Prishtinës

Disa nga punët e realizuara në 6
mujorin e parë, 2015



Administrata

- Vetëshërbimi i parë digjital në Ballkan për shërbime të Zyrës së Gjendjes Civile
 - E-rekrutimi; Aplikimi “online” për vende të punës
 - Pajisjet elektronike për matjen e sipërfaqeve
 - Uniformat për punëtorët
- Se shpejti...
 - Platforma lëvizëse për qasje për persona me nevoja të veçanta
 - Matja e ndotjes së ajrit (në 6 lokacione në Prishtinë, do të matet ndotja e ajrit, radioaktiviteti dhe niveli i zhurmës në kohë reale)



Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale


- Hapja e QMF-së në lagjen e Muhaxherëve
- Renovimi i 5 QMF-ve
- Vizitat sistematike në të gjitha shkollat (raporti publikohet me datë 10 korrik)
- 1000 përfitues të asistencës sociale
- Dezinsektimi për here të parë në 5 faza, në 6 mijë hektarë, edhe në disa zona rurale

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

- Tregu Mobil për prodhime vendore hapet në Shtator, projekt me Komisionin Evropian në vlerë prej 500,000 euro
- Për herë të parë 1 milion euro subvencione për fermerët e Prishtinës
- Mbështetja për “Business Process Outsourcing” kompanitë (mbi 200 vende të punës sivjet)
 - Marrëveshja me Qeverinë gjermane - HELP 100 grante deri në 2 mijë euro për bizneset e Prishtinës


Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

- Rritet në 250,000 euro shuma për subvencionet në sport, shtohen subvencionet në kulturë
- Përfundimi i punimeve në pishinën e Gërmisë (hapja me 11 Korrik)
- Aktivizimi i shtëpizave në Gërmi për kampe verore për nxënësit e Prishtinës
- Projektimi i këndeve të lodrave dhe hapësirave sportive




Drejtoria e Shërbimeve Publike

- 1600 fidane të mbjellura vetëm në pjesën e parë të vitit
- Revitalizimi i shumë hapësirave në qytet
- Vazhdimi i zgjerimit të ndriçimit (planifikohen rreth 50 km për vitin 2015)
- Radarët e shpejtësisë në disa pjesë të qytetit
- Shpimi i puseve dhe pastrimi i bodrumeve në lagje të ndryshme




Drejtoria e Arsimit

- Hapet më 1 gusht, çerdhja “Botanika” në lagjen Mati 1
- Më 1 shtator, hapja e çerdhes “Ngjyrat”, në Hajvali si dhe hapja e çerdhes në fshatin Besi
- Fillon ndërtimi i çerdhes në lagjen “Arbëria”
- Fillon ndërtimi i çerdhes në lagjen “Kodra e Trimave”
- Fillon ndërtimi i Shkollës Fillore në lagjen Mati1
- Fillon ndërtimi i Shkollës Fillore në lagjen “Kalabria”
- Në shtator fillon pilotimi i mësimit tërëditor në 3 shkolla
- Në shtator fillon pilotimi i ditarëve elektronik në 5 shkolla, ndërsa nxënësve, pos kifleve, do ju shërbehet edhe qumësht




Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

- Permit Tracking System
- Regjistrimi i 46 mijë ndërtimeve pa leje
- Plani i veprimit në mjedis
- Lejet në 2015 në 6 muaj më shumë se sa në çdo vit tjetër individualisht




Drejtoria e Inspekcionit

- Parandalimi i ndërtimeve pa leje dhe rrënimi i tyre
- Parandalimi i uzurpimeve të hapësirave publike dhe atyre komunale
- Rrënimi i objekteve të rrezikshme për sigurinë dhe shëndetin publik
- Vendosja e ligjshmërisë
 - për shitësit ambulant dhe parkingjet ilegale
 - Lojërat e fatit
- Parandalimi i keqpërdorimit dhe keq menaxhimit të ujit të pijshëm
- Mbrojtja e ambientit nga ndotja, degradimi dhe dëmtimi




Drejtoria e Financave dhe Pronës

- Harmonizimi i procedurave të brendshme me kornizën legislative
- Regjistrimi i të gjitha pronave për tatim në pronë
- Pastrimi i data bazës nga gabimet dhe informatat e pasakta
- Reforma e tatimit në pronë për vitin 2016
- Përshkallëzimi i normave të tatimit në pronë
- Menaxhimi më i mirë i pronës komunale



Drejtoria e Kadastrit

- Ri-ndërtimi i informacionit kadastral në 2 lagje/distrikte të qytetit të Prishtinës
- Vazhdimi i projektit të regjistrimit të kadastrit të përçojave, objekteve nëntokësore dhe kadastrit etazhor të ndërtesave – KEPON
- Incizimi gjeodezik i hapësirave të përbashkëta banesore në qytetin e Prishtinës



Drejtoria e Infrastrukturës Lokale

- Gjatë vitit 2015 deri më tani janë nënshkruar 47 kontrata dhe në shumicën prej tyre kanë filluar punimet
- Buxheti 18 milionë euro për projekte kapitale
- Projektet kryesore:
- Platotë në lagjen “Dardania” (mbi kurriz, çerdhja Lulevera, pranë PTK)
- Bulevardi në rrugën Garibaldi dhe rikonstruimi i rrugës Luan Haradinaj,
- Shtrimi i rrugëve me kubëza betoni në disa lagje të Prishtinës
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve në disa fshatra të Prishtinës (Prugoc, Bardhosh, Besi, Barilevë, Vranidoll, Bërnice, Sinidoll, Mramor etj)

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale II

- Shtrimi i rrugëve në shumë fshatra të Prishtinës (Koliq, Marec, Rimanishtë, Llukar, Dabishec, Hajkobillë, Mramor, Slivovë, Barilevë, Besi, Prugoc, Bardhosh, Bërnice, Sinidoll, etj)
- Dy kontrata kornizë për sanimin e gropave dhe kanalizimeve.
- Gjatë vitit 2014 kanë përfunduar 12 kontrata të cilat janë nënshkruar gjatë vitit 2015.
- Projektet kryesore:
 - Ndërtimi i rrugës Vlora dhe kanalizimi, ndërtimi i rrugës Bërnice e Epërme – Siqevë dhe rruga Siqevë – Sharban.

Drejtoria e Infrastrukturës Lokale III

- Gjatë vitit 2014 kanë filluar punimet në 28 kontrata të cilat janë bartur në vitin 2015.

Projektet kryesore:

- Kolektori në fshatin Shkabaj, ndërtimi i rrugës paralele me rrugën e Shkupit, kolektori mbi lumin Mat, ndërtimi i rrugës Malush Kosova, ndërtimi i rrugës Stambolli, rruga Enver Maloku – pjesa e dytë etj.

Zyra për Marrëdhënie me Publikun

- Në gjashtë mujorin parë, 260 njoftime dhe komunikata, të publikuara në 2 ueb portalet zyrtare dhe rrjete sociale (43 në muaj)
- 300 prononcime dhe intervista të aranzhuara dhe të dhëna nga ZMP për radio dhe televizione, (50 në muaj)
- 360 prononcime dhe intervista për gazeta dhe portale të aranzhuara dhe të dhëna nga ZMP , (60 në muaj)
- 40 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të procesuara
- Publikimi i njoftimeve të veçanta në të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike dhe rrjetet sociale